

SI TË RAPORTOHET KORRUPSIONI DHE TË SIGUROHET MBROJTJA LIGJORE?.....	3
INFORMATA KYÇE MBI SINJALIZIMIN	4
Çka është sinjalizimi?	4
Kush mund të raportojë shkeljen?	4
Kujt i mundësohet mbrojtja në rast të raportimit të shkeljeve?	4
A mundet shkelja të raportohet në mënyrë anonime?.....	4
A është sinjalizimi konfidencial?	5
Cilat shkelje mund të raportohen?	5
A janë të domosdoshme provat apo mjafton dyshimi i arsyeshëm se informacioni për një shkelje është i saktë?	6
A mund të vlerësohet motivi i sinjalizuesit në kushte të “mirëbesimit”	6
Çfarë lloj mbrojtjeje parashihet me ligj për sinjalizuesit?	6
A janë sinjalizuesit imun ndaj përgjegjësisë disiplinore, civile dhe penale në lidhje me raportimin e shkeljeve?	6
Si trajtohet abuzimi i të drejtës për të raportuar shkeljen?	7
PROCEDURAT E SINJALIZIMIT?.....	8
Si mund të raportohet shkelja?.....	8
Cila është procedura për raportim të brendshëm?	8
Cila është procedura për raportim të jashtëm?.....	10
Sinjalizimi i jashtëm për sektorin publik	10
Cila është procedura pas pranimit të raportimit të jashtëm?	10
A ka dënime për shkeljet e procedurave për pranimin, hetimin dhe kontrollimin e raporteve, cilat janë ato dhe ndaj kujt aplikohen?.....	11
Në cilat rrethana lejohet shpалosja publike?.....	12
MBROJTJA E SINJALIZUESVE NGA HAKMARRJA?	13
Kundrejt cilit tip të hakmarrjes, sinjalizuesi gëzon mbrojtje?	13
Kush ka të drejtë në mbrojtje?.....	14
Nga kush mund të kërkohet mbrojtja?	14
MBËSHTETJA JURIDIKE PËR SINJALIZUESIT?.....	15
Cila mbështetje ligjore është e disponueshme për sinjalizuesit?	15
Cilat materiale informative mbi sistemin e sinjalizuesve janë në dispozicion nga institucionet/organizatat e tjera dhe në çfarë formati?	15
INFORMATA DHE BURIME TË MËTEJSHME	16
Linqet e agjensive dhe organizatave relevante dhe kontaktet e tyre	16

Linqet e raporteve të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizimit 16

SI TË RAPORTOHET KORRUPSIONI DHE TË SIGUROHET MBROJTJA LIGJORE?

Kjo përmbajtje synon t'i ofrojë publikut informacion mbi mundësitë e mbrojtjes ligjore të raportimit të korrupsionit në Kosovë. Këtu mund të mësoni se çfarë do të thotë raportim i mbrojtur, kush mund të raportojë korrupsionin dhe cilat shkelje mund të raportohen. Ju gjithashtu mund të mësoni se si t'i raportoni shkeljet dhe kujtë të i drejtoheni. Përmbajtja e mëposhtme ofron informacion mbi mundësitë e mbrojtjes ligjore kundër veprimeve të dëmshme që mund të ndërmerren për të penguar raportimin e shkeljes ose hakmarrjen si rezultat i raportimit.

Bazuar në informacionin e mëposhtëm, ju mund të vlerësoni informacionin që keni në dispozicion që mund të tregojë korrupsion dhe të vendosni nëse informacioni juaj ofron një bazë për raportimin e mbrojtur të korrupsionit dhe cilat janë pasojat e mundshme të raportimit të korrupsionit dhe abuzimit të raportimit të korrupsionit.

Kjo përmbajtje është përgatitur në bazë të rregullores në fuqi, në radhë të parë Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Informacioni i dhënë nuk shërben si këshillë ligjore dhe për këtë arsye rekomandohet konsultimi i rregullores në detaje dhe adresimi i autoriteteve kompetente për udhëzime specifike. Kjo përmbajtje ofron informacion në lidhje me institucionet përkatëse që ofrojnë ndihmë juridike për sinjalizuesit.

INFORMATA KYÇE MBI SINJALIZIMIN

Çka është sinjalizimi?

Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve rregullohet me Ligjin nr. 06/L –085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (tutje: Ligji). Gjithashtu, sinjalizimi në sektorin publik është i rregulluar me Rregulloren (QRK) - NR.03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit (tutje: Rregullorja).

Sinjalizimi nënkupton raportimin ose zbulimin e informacionit mbi veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose dëm të interesit publik. Raportimi përfshin raportimin brenda një institucioni publik ose subjektit privat ose autoritetit kompetent, ndërsa, zbulimi nënkupton bërjen publike të informacionit.

Sipas ligjit, sinjalizues është çdo person që raporton ose zbulon informacione mbi kërcënimin ose dëmtimin e interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së tij të punës në sektorin publik ose privat.

Kush mund të raportojë shkeljen?

Secili person në kontekst të marrëdhënies së punës, në sektorin publik apo privat, përfshirë edhe sektorin jo-qeveritar mund të raportojë shkeljet.

Personi në kontekst të marrëdhënies së punës konsiderohet secili person që është apo ka qenë në marrëdhënie pune (pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja ose paga), bashkëpunëtori i jashtëm ose i rastit, vullnetari, që është në praktikë profesionale ose trajnim, kandidat për punësim, kryen praktikë profesionale ose trajnim apo në marrëdhënie kontraktuale të punës, shërbimit ose lloje të tjera bashkëpunimi apo përdorim i shërbimeve të institucionit publik ose subjektit privat, përfshirë kontraktimin ose nën kontraktimin.

Kujt i mundësohet mbrojtja në rast të raportimit të shkeljeve?

Sinjalizuesit kanë të drejtë në mbrojtje nga raportimi i shkeljeve.

Gjithashtu, personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova lidhur me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin ka të drejtë në mbrojtje. Kjo vlen edhe për personin që dëshmon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tyre për shkak se personi që ndërmerr veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me sinjalizuesin.

Zyrtari përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, gjithashtu gëzon mbrojtje, nëse dëshmohet se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij/saj në lidhje me pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit.

A mundet shkelja të raportohet në mënyrë anonime?

Kjo çështje nuk është rregulluar me ligj.

A është sinjalizimi konfidencial?

Të dhënat personale përfshijnë çdo informacion lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Të dhënat personale të sinjalizuesit dhe të personave të tjerë të përfshirë në sinjalizim (vetëm ato që janë relevante), përpunohen vetëm për qëllime të procedurave të sinjalizimit.

Mbrojtja e informatave identifikuese është e obligueshme të bëhet nga zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër i cili pranon apo përpunon raportime në interes publik. Përveç të dhënave personale që lidhen me sinjalizuesit, ligji parashikon që procedura në lidhje me sinjalizimin dhe informacionet e raportuara të jenë gjithashtu konfidenciale.

Në rastin e sinjalizuesve në sektorin publik. Rregullorja përcakton se dërgesat postare duhet të hapen vetëm nga zyrtari përgjegjës. Institucionet duhet të krijojnë email të veçantë për sinjalizim. Nëse një raport i sinjalizimit dorëzohet tek institucioni pa një adresë ose tek një person tjetër brenda institucionit, shkresa duhet të përcillet menjëherë tek zyrtari përgjegjës. Zyrtari përgjegjës duhet të informojë personin raportues për pranimin e raportimit. Sinjalizuesi mund të jap pëlqimin e tij/saj për zbulim të identitetit në përgjithësi apo zbulim të identitetit vetëm tek autoritetet e tjera kompetente.

Zyrtari përgjegjës, duhet të marrë pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit në rast se i kërkohet të japë të dhëna që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit tek një autoritet kompetent për veprime që nuk mund të ndërmerren pa e zbuluar identitetin e sinjalizuesit.

Në rastet kur kërkohet me ligj të zbulohet identiteti i sinjalizuesit, zyrtari përgjegjës njofton sinjalizuesin për këtë fakt para si t'ia zbulojë identitetin.

Nëse zyrtari përgjegjës nuk ruan konfidencialitetin, gjykata kompetente shqipton gjobë prej 500 deri në 20.000 euro.

Cilat shkelje mund të raportohen?

Raportimi dhe shpалosja në interes publik është e mbrojtur kur:

1. shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet;
2. personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor;
3. ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë;
4. shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet;
5. mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet;
6. ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit të parave publike ose resurseve të një institucioni publik, kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë;
7. një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keqadministrim të rëndë;

8. informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet si më lartë ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar.

Raportimi apo shpalosja do të supozohet se është në interes publik, përveç nëse vërtetohet e kundërta.

[A janë të domosdoshme provat apo mjafton dyshimi i arsyeshëm se informacioni për një shkelje është i saktë?](#)

Në pajtim me ligjin, për raportimin e një shkeljeje, është i mjaftueshëm besimi apo dyshimi i arsyeshëm se informacioni rreth një shkelje është i vërtetë.

Dyshimi i arsyeshëm paraqet njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një shkelje ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që të ndodhë.

Sidoqoftë, kur pranohet një sinjalizim në interes publik, zyrtari përgjegjës kryen një hetim administrativ të sinjalizimit të bërë. Hetimi duhet të kryhet në atë mënyrë që të përcaktohet në mënyrë objektive dhe të drejtë nëse pretendimet në raportimin në interes publik janë të mbështetura në provat e mbledhura. Kështu, rezultatet e hetimit janë të varura nga provat e disponueshme për një shkelje të caktuar. Gjatë këtij hetimi, si prova mund të përdoren të dhënat zyrtare, dokumentet dhe dosjet e institucionit përkatës, përfshirë, por pa u kufizuar në vendimet administrative ose çfarëdo vendimi tjetër dhe zbatimi i tyre, rregullat e brendshme, shënimet e procedurave të brendshme lidhur me vendimet përkatëse si procesverbalet e takimeve, kopjet e çdo komunikimi në mes të zyrtarëve në lidhje me vendimet apo procedurat që janë objekt i sinjalizimit, intervistat me persona nga institucioni të cilët janë subjekt i raportimit në interes publik, ose personave të tjerë relevant dhe informatat në dispozicion publik.

[A mund të vlerësohet motivi i sinjalizuesit në kushte të “mirëbesimit”](#)

Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar. Fakti që raportimi në interes të publikut mund t'i shërbejë avancimit të interesave të tij/saj nuk do të thotë se raportimi nuk është në interesin publik.

[Çfarë lloj mbrojtjeje parashihet me ligj për sinjalizuesit?](#)

Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin që ka vuajtur nga veprime të dëmshme në lidhje me sinjalizimin mund të kërkojë mbrojtje nga efektet e dëmshme që lidhen me sinjalizuesin. Mbrojtja është gjyqësore dhe mund të kërkohet nga gjykata.

Të gjitha llojet e hakmarrjes për të cilat sinjalizuesi mund të kërkojë mbrojtje, me ligj, zbatohen si për personat që ndihmojnë sinjalizuesit ashtu edhe për oficerët përgjegjës për trajtimin e raporteve të sinjalizuesit.

[A janë sinjalizuesit imun ndaj përgjegjësisë disiplinore, civile dhe penale në lidhje me raportimin e shkeljeve?](#)

Sinjalizuesi që raporton ose shpalos informata në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore.

Si trajtohet abuzimi i të drejtës për të raportuar shkeljen?

Abuzimi me sinjalizim ndalohet. Abuzimi me sinjalizim përfshin rastet kur:

1. Sinjalizimi nuk është kryer për arsytet e përcaktuara në Ligj.
2. Raportimi ose zbulimi kryhet në bazë të fakteve, informacioneve ose dokumenteve të ofruara në lidhje me dispozitat e ofrimit të ndihmës juridike .
3. Sinjalizuesi raporton ose zbulon informacionin që ai/ajo ka ose mund të jetë në dijeni se e di ose duhet ta dijë se është i rremë.

Në përputhje me Ligjin, mbrojtja e sinjalizuesit nuk jepet në rastet kur sinjalizuesi raporton ose zbulon informacione që ata e dinë ose mund të kenë dijeni se janë të rreme. Si rezultat i raportimit të rrejshëm personi i caktuar mund të jetë subjekt i përgjegjësisë disiplinore brenda institucionit ku punon, përgjegjësisë civile nëpërmjet ngritjes së padisë nga institucioni ose ndonjë palë tjetër që është dëmtuar nga raportimi i rremë me vetëdije, ose përgjegjësia penale për deklarime të rreme. Personi kundër të cilit është bërë kallëzim apo zbulim i rremë mund të paraqesë kërkesë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente.

PROCEDURAT E SINJALIZIMIT?

Si mund të raportohet shkelja?

Sinjalizimi i brendshëm përfshin raportimin e shkeljeve brenda një institucioni publik ose privat.

Për rastet e sinjalizimit të jashtëm, sinjalizuesi në sektorin publik, e shpalosë informacionin tek Agjencia kundër Korrupsionit derisa sinjalizuesi në sektorin privat, e raporton shkeljen tek Inspektorati i Punës.

Shpalosja e informacionit është gjithashtu një prej llojeve të sinjalizimit. Shpalosja nënkupton bërjen publike të informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik.

Cila është procedura për raportim të brendshëm?

Sinjalizuesi e shpalosë informacionin tek zyrtari përgjegjës në institucionin publik ose privat.

Punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar është i obliguar të caktojë zyrtarin përgjegjës dhe ta publikojë emrin e zyrtarit përgjegjës në faqen zyrtare. Nëse punëdhënësi nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës (për shkak se nuk ka qenë i obliguar apo për shkak se nuk e ka zbatuar këtë obligim) atëherë ju mund të sinjalizoni tek drejtuesi i institucionit publik.

Punëdhënësi në sektorin privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar është i obliguar të caktojë zyrtarin përgjegjës dhe ta njoftojë stafin lidhur me zyrtarin përgjegjës. Nëse punëdhënësi nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës (për shkak se nuk është i obliguar apo për shkak se nuk e ka zbatuar këtë obligim) atëherë ju mund të raportoni tek drejtuesi i institucionit privat.

Sinjalizuesi mund të paraqesë një raport direkt te menaxheri i personelit, në rast se ai/ajo:

- 1) ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të jetë i përfshirë në praktikën e dyshuar, ose
- 2) ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës, për shkak të ndonjë marrëdhënieje apo shoqërimi me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në rastin e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i duhur për t'u informuar për sinjalizimin.

Nëse sinjalizimi ka të bëjë me titullarin e institucionit, sipas Ligjit, sinjalizuesi mund të bëjë drejtpërdrejt sinjalizimin e jashtëm.

Informacioni i raportimit duhet të jetë i kuptueshëm dhe duhet të përmbajë të dhënat për personin kundër të cilit është bërë raportimi, si dhe faktet që disponon sinjalizuesi. Raporti mund të dorëzohet me shkrim, me postë ose me e-mail dhe gojarisht.

Për raportimin e brendshëm në sektorin publik, sinjalizuesi mund të përdorë formularin për raportimin në interes publik. (Ky formular gjendet tek <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/Formular-per-raportimin-ne-interes-publik.doc>). Të dhënat të cilat kërkohen në këtë formular janë emri i personit raportues, kontaktet, data e dorëzimit, pëlqimi për zbulim të konfidencialitet (në përgjithësi apo vetëm në raport me autoritetet e tjera kompetente), emri i entitetit me të cilin sinjalizuesi është në marrëdhënie të natyrës së punës, natyra e

marrëdhënies së punës, përshkrimi i shkurtër i pretendimeve apo çështjes shqetësuese dhe provat dhe burimet e informacionit të cilat duhet të konsultohen.

Për sa i përket sinjalizimit në sektorin publik, zyrtari përgjegjës siguron mbajtjen e një regjistri të raporteve të sinjalizuesve për institucionin. Sipas Rregullores, regjistri është i sigurt, me qasje vetëm nga zyrtari përgjegjës. Gjithashtu, punëdhënësi krijon një kod protokollit të posaçëm për rastet e sinjalizimit dhe siguron një sirtar të veçantë dhe të sigurt për arkivimin e dosjeve të rasteve të sinjalizimit brenda arkivit të institucionit, me akses vetëm nga zyrtari përgjegjës. Nëse sinjalizuesi ka kërkuar që të ruhet konfidencialiteti i tij/saj, emri i sinjalizuesit nuk do të përfshihet në raportin për hetimin e raportit të sinjalizuesit, por vetëm në regjistër.

Zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën e paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Në rastin e sektorit publik, përveç Ligjit, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën e paraparë me Rregulloren për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit. Kjo rregullore vlen vetëm për sektorin publik.

Sipas ligjit, secilës palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pala: 1) mund të paraqesë deklaratë me shkrim; 2) mund të paraqesë prova ose mendime; 3) mund të konsultohet me dosjen e hetimit; 4) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

Në rastet e sinjalizimit në sektorin publik, pas marrjes së informacionit, zyrtari përgjegjës kryen një vlerësim fillestar të raportit të marrë. Një raport nuk do të hetohet në rastet e mëposhtme:

- 1) objekti i raportimit shihet qartë që nuk ka të bëjë me interesin publik.
- 2) nëpunësi përgjegjës pranon një raport në lidhje me një veprim ose lëshim të pretenduar në interes publik, i cili është jashtë kompetencave të institucionit ku është emëruar zyrtari përgjegjës (në këto raste, zyrtari përgjegjës ia referon menjëherë çështjen organit kompetent dhe njofton sinjalizuesin për këtë);
- 3) raportimi përmban informata konfidenciale të cilat janë të klasifikuara sipas Ligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimet e Sigurisë, dhe informatat e tilla nuk janë në kompetencë të institucionit (në këto raste raporti duhet t'i dorëzohet institucionit kompetent).

Në raste tjera raportimi duhet të hetohet.

Sipas ligjit, procedura e brendshme e hetimit administrativ të sinjalizimit inicohet nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar. Brenda afatit prej 15 ditëve, sinjalizuesi duhet të njoftohet për pranimin apo refuzimin e raportimit të tij. Nëse nuk ndërmirren veprimet pas raportimit të informacionit, ligji parasheh gjobë në lartësi nga 500 deri në 20.000 euro.

Procedura e hetimit administrativ në lidhje me sinjalizimin duhet të përfundojë sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se 45 ditë nga momenti i raportimit, përveç se kur nga rrethanat e rastit kërkohet shtyrja e afatit, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 45 ditë.

Punëdhënësi është i detyruar të marrë masa të menjëhershme, sa më shumë që të jetë e mundur, për të parandaluar ose shuar pasojat e dëmshme të sinjalizimit.

Sipas ligjit, nëse në përfundim të procesit të hetimit administrativ të sinjalizimit nga punëdhënësi, rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e raportuar përbën ose mund të përbëjë shkelje ligjore, punëdhënësi njofton organin kompetent.

Cila është procedura për raportim të jashtëm?

Sinjalizimi i jashtëm mund të bëhet vetëm pasi sinjalizuesi ta ketë bërë sinjalizimin e brendshëm, apo të zgjedhë drejtpërdrejt të bëjë sinjalizim të jashtëm në rastet kur:

- 1) Sinjalizimi ka të bëjë me drejtuesin e punëdhënësit,
- 2) Sinjalizimi ka karakter urgjent që ndërlidhet me një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm ose dëme të pakthyeshme;
- 3) Ka dyshime të arsyeshme se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit, provat mund të fshihen ose asgjësohen nëse ky do të kryente sinjalizim të brendshëm; 4. Sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.
- 4) Kur sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

Sinjalizimi i jashtëm për sektorin publik

Në rastin e sinjalizimit të jashtëm, sinjalizuesi në sektorin publik e paraqet informacionin tek Agjencia kundër Korrupsionit ndërsa sinjalizuesi në sektorin privat tek Inspektorati i Punës.

Për të parandaluar konfliktin e interesit në adresimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm mbrojtja nga konflikti i interesit, në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, aplikohet, dhe lidhet, mes tjerash me Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Inspektoratin e Punës.

Informata duhet të jetë e kuptueshme dhe duhet të përmbajë të dhënat e personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi si dhe faktet të cilat i disponon sinjalizuesi. Sipas ligjit, sinjalizimi mund të paraqitet me shkrim, me postë, e-mail apo gojarisht. Formulari i raportimit për raportimin e jashtëm për sektorin publik është në dispozicion në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/Formular-per-raportimin-ne-interes-publik.doc>.

Rregullorja e Agjencisë kundër Korrupsionit kërkon mbajtjen e shënimeve të përditësuara për rastet e raportuara.

Cila është procedura pas pranimit të raportimit të jashtëm?

Agjencia kundër Korrupsionit/Inspektorati i Punës inicon procedurën e hetimit administrativ në momentin e pranimit të raportimit. Sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në rastin e sinjalizuesve në sektorin publik, përveç Ligjit, zbatohen edhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë kundër Korrupsionit.

Sinjalizuesi duhet të njoftohet për pranimin ose refuzimin e sinjalizuesit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së raportit të sinjalizuesit. Në rastet e sektorit publik, Agjencia kundër Korrupsionit shqyrton rastet e sinjalizimit që hyjnë në fushëveprimin e saj (për shembull, parandalimi i konfliktit të interesit). Nëse Agjencia kundër Korrupsionit nuk ka autoritet për të vepruar, ajo ia përcjell informacionin autoritetit kompetent (për shembull Policisë ose Prokurorit të Shtetit në rastet e veprave penale) pa vonesë, si dhe informon sinjalizuesin për këtë veprim.

Agjencia kundër Korrupsionit/Inspektorati i Punës është i detyruar të marrë masa të menjëhershme sa më shumë që të jetë e mundur, të parandalojë pasojat e dëmshme ose të parandalojë vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e sinjalizimit të dyshuar.

Sipas ligjit, çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pala: 1) mund të japë deklaratë me shkrim; 2) mund të paraqesë prova ose opinione; 3) mund të konsultohet me dosjen e hetimit; 4) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

Në fazën e hetimit administrativ, Agjencia kundër Korrupsionit/ Inspektorati i Punës shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi si dhe mund të kërkojë informacion shtesë dhe dokumente relevante, të urdhërojë inspektime ose të marrë deklaratë nga personat në dijeni për çështjen, si dhe të konsultohet me ekspertë të fushës përkatëse. Në hetimin administrativ mund të marrë pjesë sinjalizuesi dhe personi i tretë për të cilin besohet se ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara apo posedon dokumentacion relevant. Në rastet e sinjalizimit të jashtëm në sektorin publik zhvillohet një procedurë hetimi paraprak përpara hetimit administrativ.

Sipas ligjit, procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se 45 ditë nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar, përveç se kur nga rrethanat e rastit kërkohet shtyrja e afatit. Afati nuk mund të shtyhet më shumë se edhe 45 ditë të tjera.

Agjencia kundër Korrupsionit/Inspektorati i Punës është i detyruar të njoftojë sinjalizuesin për rezultatin e procedurës, pas përfundimit të procedurës.

Sipas ligjit, nëse sinjalizuesi nuk informohet mbi rezultatin e procedurës, ligji parasheh gjobë në lartësi nga 500 deri në 20.000 euro.

Sipas ligjit, nëse në përfundim të procesit të hetimit administrativ të sinjalizimit, rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore sipas ligjit, Agjencia kundër Korrupsionit/Inspektorati i Punës vë në dijeni organin kompetent.

Për shembull, nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një shkelje disiplinore, do të njoftohet organi kompetent për zhvillimin e procedurës disiplinore. Nëse rezulton se është kryer vepër penale, atëherë do të njoftohet Prokurori i Shtetit etj.

[A ka dënime për shkeljet e procedurave për pranimin, hetimin dhe kontrollimin e raporteve, cilat janë ato dhe ndaj kujt aplikohen?](#)

Çdo veprim ose mosveprim që synon pengimin e raportimit apo shpalesjes në interes publik është i pavlefshëm dhe zyrtari përgjegjës apo cilido person tjetër në rastet përkatëse ndiqet penalisht sipas dispozitave penale në fuqi në Kosovë.

Çdo dispozitë në një marrëveshje është e pavlefshme nëse synon të: 1) Ndalojë ose kufizojë raportimin apo shpalesjen në interes publik; 2) Përrjashtojë ose kufizojë zbatimin e ndonjë dispozite të këtij ligji; 3) Pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë në bazë të këtij ligji; 4) Pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë për shkelje të kontratës në lidhje me çdo gjë që bëhet si pasojë e raportimit apo shpalesjes së informatave në interes publik.

Për pengim të sinjalizimit, gjykata kompetente shqipton gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëzet mijë (20.000) euro për institucionin publik apo subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës (Agjensia Kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Punës). Këto dënime aplikohen nëse:

1. Nëse institucioni publik apo subjekti privat apo autoriteti kompetent nuk ndërmerr veprime pas pranimit të raportit brenda afatit të përcaktuar me ligj,
2. nëse nuk i informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës, brenda afatit të caktuar,
3. nëse nuk i informon sinjalizuesit, me kërkesën e tij/saj, për ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nëse nuk i lejon sinjalizuesit të ketë qasje në dosjen e lëndës dhe të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit,
4. nëse nuk i përmbahet konfidencialitetit siç kërkohet me ligj.

Për të njëjtat shkelje (me përjashtim të detyrimit për të njoftuar sinjalizuesin për rezultatin e procedurës) zyrtari përgjegjës mund të gjobitet me 300 deri në 2.000 euro. Nëse zyrtari përgjegjës është recidivist, ndaj tij mund të shqiptohet gjobë deri në 4.000 euro.

Në cilat rrethana lejohet shpалosja publike?

Shpалosja publike apo sinjalizimi publik mund të bëhet në situata kur:

- 1) në kohën kur sinjalizuesi që bën shpалosjen, me arsye beson se ai do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm;
- 2) Sinjalizuesi me arsye beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen nëse sinjalizuesi bën raportim të brendshëm apo të jashtëm,
- 3) Në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme;
- 4) Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në lidhje me sinjalizimin brenda afatit prej gjashtë muaj nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.

Shpалosja publike mund të bëhet në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik.

Sinjalizuesi i cili shpалos informacionin tek publiku në pajtim me këtë ligj, është i obliguar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore.

MBROJTJA E SINJALIZUESVE NGA HAKMARRJA?

Kundrejt cilit tip të hakmarrjes, sinjalizuesi gëzon mbrojtje?

Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm i marrë ndaj tij nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit në pajtim me dispozitat e ligji, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

1. shkarkimin nga puna;
2. pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
3. transferimin brenda ose jashtë institucionit publik ose subjektit privat pa pëlqimin e tij;
4. uljen në pozitë;
5. zvogëlimin e pagesës;
6. humbjen e statusit dhe privilegjeve;
7. mosngritjen në pozitë;
8. heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
9. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
10. anulimin e një licence ose leje;
11. përfundimin e një kontrate për mallra apo shërbime;
12. veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.

Të gjitha veprimet hakmarrëse ndaj sinjalizuesve, janë subjekt i dënimeve kundërvajtëse dhe penale.

Sipas ligjit, në rast se institucionin publik apo subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerret të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm, si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm, brenda kompetencave të veta, gjykata kompetente shqipton gjobë nga 500 deri në 20.000 euro. Për këto veprime, ndaj zyrtarit përgjegjës gjykata kompetente shqipton gjobë nga 300 deri në 2.000 euro (Nëse zyrtari përgjegjës është recidivist, gjykata mund ti shqiptojë të njëjtit gjobë deri në 4.000 euro).

Kush ka të drejtë në mbrojtje?

Sinjalizuesi mund të kërkojë mbrojtje nga hakmarrja. Si dhe të gjitha llojet e hakmarrjes për të cilat sinjalizuesi mund të kërkojë mbrojtje, me ligj parashihet për të gjithë personat që ndihmojnë sinjalizuesit apo zyrtarët përgjegjës për trajtimin e raporteve të sinjalizimit.

Nga kush mund të kërkohet mbrojtja?

Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin i cili ka pësuar nga veprimet e dëmshme në lidhje me sinjalizimin, ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, pa qenë i detyruar të shterojë mjetet juridike të brendshme në procedurë administrative. Sinjalizuesi mund të kërkojë mbrojtje nga veprimet e dëmshme apo kompensim për dëmin e shkaktuar.

Në të gjitha rastet kur sinjalizuesi ose personi i lidhur me sinjalizuesin konsideron se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, punëdhënësi e ka barrën e provës të provojë se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin.

Sipas ligjit, sinjalizuesit mund të paraqesin:

- 1) Padi kundër veprimit të dëmshëm dhe
- 2) Kërkesë për kompensim dëmi.

Në rastet kur gjykata kompetente vërteton se sinjalizuesi në kontekst të marrëdhënies së punës ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, vendos, sipas rastit, që ta kthejë në vendin e tij të punës, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të urdhërojë institucionin publik apo subjektin privat të ndërmarrë veprime të caktuara. Të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin, trajtohen me prioritet nga Gjykata.

Padia kundër veprimit të dëmshëm i paraqitet gjykatës në afat prej gjashtë muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni por jo më vonë se tri vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm.

Për rastet që kanë të bëjnë me zyrtarë publik padia dorëzohet në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Për rastet që kanë të bëjnë me kategori të tjera të të punësuarve, padia dorëzohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, ku ndodhet selia e punëdhënësit apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.

Po ashtu, nëse sinjalizuesi apo personi i lidhur me sinjalizuesin i nënshtrohet ndonjë forme të hakmarrjes për shkak të sinjalizimit të bërë, mund të parashtrijë kallëzim penal në prokurorinë kompetente. Sipas Kodit Penal, kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm ndaj një personi me qëllim hakmarrjeje për shkak të raportimit ose zbulimit të informacionit për veprime dhe mosveprime që përbëjnë kërcënim ose cenim të interesit publik, dënohet me gjobë ose gjer në 2 vjet burg.

MBËSHTETJA JURIDIKE PËR SINJALIZUESIT?

Cila mbështetje ligjore është e disponueshme për sinjalizuesit?

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas në Kosovë, ofron ndihmë juridike në çështjet e procedurës civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse. Përfitues të ndihmës juridike falas nga kjo Agjenci mund të jenë personat të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Ndhmë Juridike Falas. Sinjalizuesit nuk janë një kategori që përfiton automatikisht nga ndihma juridike falas. Për të marrë ndihmën juridike falas, ata duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Ndhmën Juridike Falas, të cilat janë kriteret e kualifikimit, kriteret financiare dhe kriteret ligjore.

Ndhmë Juridike në këtë fushë ofron edhe Qendra për Ndhmë Juridike e Institutit të Kosovës për Drejtësi. Kjo qendër ofron ndihmë juridike falas për sinjalizuesit e rasteve të korrupsionit në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë. Ndhma juridike falas që ofrohet nga kjo qendër përfshinë, por nuk kufizohet në ofrimin e këshillave ligjore lidhur me të drejtat dhe obligimet e sinjalizuesve, dhënien e këshillave apo përfaqësimin me avokat në rast të shkeljes së të drejtave të sinjalizuesve dhe formave tjera që kanë për qëllim promovimin dhe respektimin e të drejtave të sinjalizuesve qoftë pranë organeve administrative apo gjyqësore.

Cilat materiale informative mbi sistemin e sinjalizuesve janë në dispozicion nga institucionet/organizatat e tjera dhe në çfarë formati?

Informata të përgjithshme në Faqen Zyrtare të Zyrës së Kryeministrit, të disponueshme në:

<https://kryeministri.rks-gov.net/kontakti/mbrojtja-e-sinjalizuesve/>

Udhëzues për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i disponueshëm në:

<http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/06/Udhëzues-për-Mbrojtjen-e-Sinjalizuesve.pdf>

Manual për Zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i disponueshëm në:

<https://fit-ks.org/wp-content/uploads/2020/02/15-Manuali-per-Sinjalizues-FINAL.pdf>

“Sinjalizuesit e Korrupsionit” (Video), i disponueshëm në:

https://www.youtube.com/watch?v=mJeVMo_D0hc

Sinjalizues ligji të mbron ep.01 (Video), i disponueshëm në:

<https://www.youtube.com/watch?v=cii0069EeQs>

Sinjalizues, Ligji të mbron (Video), i disponueshëm në:

<https://www.youtube.com/watch?v=KLhupz6gByo>

Bëhu sinjalizues/ Become a Whistleblower (Video), i disponueshëm në:

<https://www.youtube.com/watch?v=Un6AdSELbp4>

INFORMATA DHE BURIME TË MËTEJSHME

Linqet e agjensive dhe organizatave relevante dhe kontaktet e tyre

Agjencia kundër Korrupsionit: akk-ks.org, info@akk-ks.org

Inspektorati i Punës: ip.rks-gov.net, agim.millaku@rks-gov.net

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas: <https://anjf.rks-gov.net>, Info.ANJF@rks-gov.net

Qendra për Ndhmë Juridike e Institutit të Kosovës për Drejtësi:
<https://ndihmajuridikekd.org/sinjalizuesit-e-korrupsionit/>, info@ndihmajuridikekd.org

Linqet e raporteve të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizimit

Mbrojtja e sinjalizuesve, e disponueshme në: <https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c>

Sinjalizuesit dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve në Kosovë, e disponueshme në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/FINAL-Sinjalizuesit-dhe-mbrojtja-e-sinjalizuesve-ne-Kosove.pdf>

Udhëzues për Sinjalizimin në Sektorin Privat në Kosovë, i disponueshëm në: <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/11/Udhëzues-për-sinjalizimin-në-sektorin-privat.pdf>

Doracak me 10 skenar të reagimit për rastet e sinjalizimit në sektorin privat: <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/11/Doracak-me-10-skenar%C3%AB-t%C3%AB-reagimit-p%C3%AB-rastet-e-sinjalizimit-n%C3%AB-sektorin-privat.pdf>

Manual për sinjalizuesit, i disponueshëm në: <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/07/Doracak-per-sinjalizuesit.pdf>

Manual për Zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i disponueshëm në: <https://fit-ks.org/wp-content/uploads/2020/02/15-Manuali-per-Sinjalizues-FINAL.pdf>